



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Projekt”

LIGJ

Nr._____, datë _____

“PËR
PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE PËR PROJEKTIMIN EKOLOGJIK TË
PRODUKTEVE ME NDIKIM NË ENERGJI”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton kërkesat për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energji të vendosura në treg ose të vëna në shërbim, me synim:

- përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore të produkteve.
- zvogëlimin e gjurmës së karbonit gjatë ciklit të tyre jetësor.
- garantimin e lëvizjes së lirë të këtyre produkteve brenda tregut të brendshëm.

Neni 2

Fusha e zbatimit

¹ Ky ligj është plotësisht me Direktivën (BE) 2009/125 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Tetor 2009, “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve me ndikim në energjisë”, Numri CELEX 32009L0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 285, datë 31.10.2009, f. 10–35, si dhe pjesërisht me Rregulloren (BE) 2024/1781 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 Qershor 2024, “Për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve të qëndrueshme”, Numri CELEX 32024R1781, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 1781, datë 28.6.2024, f. 1–89.

1. Ky ligj zbatohet për produkte që gjatë përdorimit kanë një ndikim të rëndësishëm, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në konsumin e energjisë dhe, sipas rastit, në burimet e tjera kryesore.
2. Ky ligj nuk zbatohet për mjetet motorrike, siç përcaktohet në pikën 3.4, Neni 3 të Ligjit Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”.
3. Ky ligj dhe kërkesat e projektimit ekologjik të miratuara në bazë të tij nuk duhet të cenojnë legjislacionin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve dhe legjislacionin kombëtar për kimikatet, duke përfshirë legjislacionin kombëtar për gazet serrë të fluoruara.

Neni 3 **Perkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. ‘Aspekt mjedisor’ nënkupton një element ose funksion të një produkti që mund të ndërveprojë me mjedisin gjatë ciklit të tij të jetës;
2. ‘Cikli i jetës’ ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
3. ‘Importues’ ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;
4. ‘Kërkesa të projektimit ekologjik’ është një kërkesë e performancës ose një kërkesë informacioni që synon ta bëjë një produkt më të qëndrueshëm për mjedisin, duke përfshirë proceset që ndodhin përgjatë zinxhirit të vlerës së produktit;
5. ‘Kërkesë e përgjithshme për projektimin ekologjik’ nënkupton çdo kërkesë për projektimin ekologjik të bazuar në profilin ekologjik në tërësi të një produkti pa vlera kufitare të përcaktuara për aspekte të caktuara mjedisore;
6. ‘Kërkesë informacioni’ është një detyrim që një produkt të shoqërohet me informacionin siç specifikohet në nenin 10;
7. ‘Kërkesë për projektimin ekologjik’ nënkupton çdo kërkesë në lidhje me një produkt, ose me projektimin e një produkti, që synon të përmirësojë performancën e tij mjedisore, ose çdo kërkesë për sigurimin e informacionit në lidhje me aspektet mjedisore të një produkti;
8. ‘Kërkesë specifike për projektimin ekologjik’ nënkupton një kërkesë të përcaktuar sasiore dhe të matshme për projektimin ekologjik që lidhet me një aspekt të caktuar mjedisor të një produkti, siç është konsumi i energjisë gjatë përdorimit, i llogaritur për një njësi të caktuar të performancës së produktit;
9. ‘Klasë e performancës’ është një sërë nivelesh të performancës në lidhje me një ose më shumë parametra produkti të përmendur në Aneksin I, e cila përcaktohet bazuar në një metodologji të përbashkët për produktin ose grupin e produktit, të renditur në mënyrë të tillë që të lejojë diferencimin e produktit;
10. ‘Konsumator’ është një person fizik ose juridik që blen, merr me qira ose merr një produkt për përdorimin e tij, pavarësisht nëse vepron ose jo për qëllime që janë jashtë tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit të tyre;
11. ‘Komponentë dhe nën-komponentë’ nënkupton pjesët e destinuara për t'u përfshirë në produkte, të cilat nuk hidhen në treg dhe/ose nuk vihen në shërbim si pjesë individuale për

përdoruesit fundorë apo performanca mjedisore e të cilave nuk mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur;

12. 'Marka CE' është një markë me të cilën prodhuesi tregon se produkti përkatës është në përputhje me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin e harmonizimit të Bashkimit Evropian që parashikon vendosjen e saj;
13. 'Materiale' nënkupton të gjitha materialet e përdorura gjatë ciklit të jetës së një produkti;
14. 'Mbetje të rrezikshme' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
15. 'Mbetje' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
16. 'Ndikim në mjedis' nënkupton efektet të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të një produkti në mjedis gjatë ciklit të tij të jetës;
17. 'Operator ekonomik' është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, shpërndarësi, shitësi dhe ofruesi i shërbimit të magazinimit dhe paketimit;
18. 'Pasaporta digjitale e produktit' është një grup të dhënash specifike për një produkt me ndikim në energji që përfshin informacionin e specifikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe që është i aksesueshëm nëpërmjet mjeteve elektronike me anë të një bartësi të të dhënave;
19. 'Përfaqësues i autorizuar' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;
20. 'Performanca mjedisore' e një produkti nënkupton rezultatet e menaxhimit nga ana e prodhuesit të aspekteve mjedisore të produktit, siç pasqyrohet në dosjen përkatëse të dokumentacionit teknik;
21. 'Përmirësimi i performancës mjedisore' nënkupton procesin e rritjes së performancës mjedisore të një produkti gjatë gjeneratave të njëpasnjëshme, megjithëse jo domosdoshmërisht në lidhje me të gjitha aspektet mjedisore të produktit në të njëjtën kohë;
22. 'Prodhues' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;
23. 'Produkt me ndikim në energji', ('produkt'), është çdo mall i vendosur në treg ose në shërbim, që gjatë përdorimit ka ndikim në energji, duke përfshirë edhe komponentët e parashikuar për t'u integruar në produktet me ndikim në energji, të cilët janë objekt i këtij ligji dhe që janë vendosur në treg dhe/ose janë vënë në shërbim, si pjesë të veçanta për përdoruesin fundor dhe për të cilat performanca mjedisore mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur;
24. 'Profil ekologjik' nënkupton përshkrimin, në përputhje me kërkesat e projektimit ekologjik përkatës për produktin me ndikim në energji, të input-eve dhe output-eve (si materialet, emetimet dhe mbetjet) të lidhura me një produkt gjatë ciklit të tij të jetës, të cilat janë të rëndësishme nga pikëpamja e ndikimit të tij në mjedis dhe shprehen në parametra fizike të matshëm;
25. 'Projekti i produktit' nënkupton tërësinë e proceseve që transferon kërkesat ligjore, teknike, kërkesat e sigurisë, ato funksionale, të tregut ose kërkesa të tjera që duhet të plotësohen nga një produkt, në specifikimin teknik për atë produkt;

26. 'Projektim ekologjik' nënkupton integrimin e aspekteve mjedisore në projektimin e produktit me qëllim përmirësimin e performancës mjedisore të produktit gjatë gjithë ciklit të tij jetësor;
27. 'Riciklim' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
28. 'Rikuperim i energjisë' jetës' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
29. 'Rikuperim' jetës' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
30. 'Ripërdorim' ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
31. 'Standard i harmonizuar' janë standardet evropiane, sikurse janë adoptuar dhe janë për t'u aplikuar sipas legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian.
32. 'Vendosje në treg' ka të njëjtin kuptim, sikurse përcaktohet në legjislacionin në fuqi, që rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;
33. 'Vënia në shërbim' është përdorimi për herë të parë i produktit, sipas qëllimit të tij të parashikuar;
34. 'Zinxhiri i furnizimit' janë të gjitha aktivitetet dhe proceset e pjesës së sipërme të zinxhirit të vlerës së produktit, deri në pikën ku produkti arrin te konsumatori;
35. 'Zinxhiri i vlerës' janë të gjitha aktivitetet dhe proceset që janë pjesë e ciklit jetësor të një produkti, si dhe riprodhimi i mundshëm i tij;

Neni 4

Vendosja në treg dhe/ose vënia në shërbim

Për produktet me ndikim në energji në përputhje me kërkesat e projektimit ekologjik, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar vendosjen në treg dhe/ose vënien në shërbim, vetëm nëse ato përmbushin kriteret e parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe mbajnë markimin CE në përputhje me nenin 6.

Neni 5

Lëvizja e lirë

Nuk ndalohet, kufizohet ose pengohet vendosja në treg a vënia në shërbim e produkteve, të cilat mbulohen dhe janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6

Markimi dhe deklarata CE e konformitetit

1. Përpara se një produkt me ndikim në energji, i mbuluar nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të vendoset në treg dhe/ose të vihet në shërbim, ai duhet:
 - (a) Të markohet me shenjën "CE", në përputhje me aktin nënligjor, të hartuar sipas nenit 23 të këtij ligji; dhe

- (b) Të shoqërohet me një deklaratë CE të konformitetit, në përputhje me elementët e specifikuar në përputhje me aktin nënligjor, të hartuar sipas nenit 23 të këtij ligji, ku prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron dhe deklaron se produkti është në përputhje me të gjitha dispozitat e kërkesave përkatëse të projektimit ekologjik.
2. Marka CE duhet të jetë e lexueshme dhe të vendoset në mënyrë të dukshme në produktin me ndikim në energji. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk garantohej për shkak të natyrës së produktit, ajo vendoset në paketim dhe në dokumentet shoqëruese.
 3. Ndalohet vendosja e shenjave markuese në një produkt që mund të ç'orientojë përdoruesit në lidhje me kuptimin ose formën e markimit CE.

Neni 7

Vlerësimi i konformitetit

1. Para hedhjes në treg të një produkti me ndikim në energji, i cili mbulohet nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, dhe/ose vënies së tij në shërbim, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të sigurojë kryerjen e vlerësimit të konformitetit të produktit me të gjitha kërkesat e projektimit ekologjik të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji.
2. Procedurat për vlerësimin e konformitetit përcaktohen në aktet nënligjore të hartuara sipas nenit 23 të këtij ligji. Kur kërkohet nga rrethanat dhe në përpjesëtim me nivelin e riskut, vlerësimi i konformitetit mund të kryhet në përputhje me modulet përkatëse, siç parashikohet në Ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.
3. Në rastet kur ekzistojnë indikacione mbi një mungesë të mundshme konformiteti të një produkti, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të publikojnë pa vonesë një vlerësim të argumentuar të nivelit të konformitetit të produktit.
4. Pas hedhjes në treg dhe/ose vënies në shërbim të një produkti me ndikim në energji, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të vërë në dispozicion për inspektim dokumentacionin përkatës mbi vlerësimin e konformitetit të kryer dhe deklaratat e konformitetit për një periudhë prej 10 vitesh nga data e fundit e prodhimit të produktit.
5. Dokumentacioni përkatës duhet të vihet në dispozicion brenda 10 ditëve nga marrja e një kërkesë nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

Neni 8

Supozimi i konformitetit

1. Një produkt që mban markimin CE, të përmendur në nenin 6, konsiderohet si në përputhje me dispozitat e aktit nënligjor përkatës të miratuar në zbatim të këtij ligji.
2. Një produkt për të cilin janë aplikuar standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian, konsiderohet si në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të projektimit ekologjik që mbulohen nga këto standarde.
3. Testimet, matjet dhe metodat e llogaritjes, të përmendura në nenin 31, të cilat janë në përputhje me standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian, supozohen të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në atë nen, si dhe me kërkesat për testimin, matjen dhe llogaritjen e

përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji, për aq kohë sa këto kërkesa mbulohen nga standardet e tilla të harmonizuara ose pjesë të tyre.

4. Pasaportat digjitale të produkteve, të cilat janë në përputhje me standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian, supozohen si në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 24 dhe 25, për aq kohë sa këto kërkesa mbulohen nga standardet e tilla të harmonizuara ose nga pjesët përkatëse të tyre.

Neni 9

Klauzolë mbrojtëse

1. Kur konstatohet se një produkt me ndikim në energji, i markuar CE të përmendur në nenin 6, nuk është në përputhje me të gjitha dispozitat e kërkesës përkatëse të projektimit ekologjik, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar është i detyruar të marrë masa që produkti të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse të kërkesës së projektimit ekologjik dhe/ose me markimin CE.
2. Kur ka prova të mjaftueshme në lidhje me mungesën e konformitetit të një produkti të caktuar me ndikim në energji, merren masat e nevojshme, të cilat, në varësi të shkallës së mungesës së konformitetit, mund të shkojnë deri në ndalimin e vendosjes së produktit në treg derisa të arrihet niveli i duhur i konformitetit.
3. Çdo vendim në përputhje me këtë ligj, i cili kufizon ose ndalon vendosjen në treg dhe/ose vënien në shërbim të një produkti, duhet të paraqesë arsyet mbi të cilat bazohet ky vendim.
4. Një vendim i tillë duhet t'i komunikohet menjëherë palës së interesuar, e cila në të njëjtën kohë duhet të informohet për mekanizmat juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi dhe për afatet kohore të cilave u nënshtrohen këto mekanizma.

Neni 10

Informimi i konsumatorëve

1. Në përputhje me kërkesën përkatëse të projektimit ekologjik, prodhuesit duhet të garantojnë, në formën që ata e gjejnë të përshtatshme, që konsumatorëve të produkteve t'u sigurohet:
 - (a) Informacioni i nevojshëm në lidhje me rolin që mund të luajnë për përdorimin e qëndrueshëm të produktit;
 - (b) Informacioni mbi performancën e produktit në lidhje me një ose më shumë nga parametrat e produktit, në përputhje me aktin nënligjor, të hartuar sipas nenit 23 të këtij ligji;
 - (c) Kur kërkohet nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, profili ekologjik i produktit dhe përfitimet që burojnë nga projektimi ekologjik.
 - (ç) Informacion për konsumatorët dhe aktorët e tjerë për mënyrën e instalimit, përdorimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të produktit, në mënyrë që të minimizohet ndikimi i tij në mjedis dhe të sigurohet durueshmëria optimale, si të instalohen sistemet operative të palëve të treta aty ku është e nevojshme, si dhe për grumbullimin për rinovim ose riprodhim, dhe për mënyrën e kthimit ose trajtimit të produktit në fund të jetës;

- (d) Informacioni për objektet e trajtimit për ç'montimin, ripërdorimin, rinovimin, riciklimin ose asgjësimin në fund të jetës;
 - (dh) Informacione të tjera që mund të ndikojnë në zgjedhjet e qëndrueshme të produktit për konsumatorët dhe mënyrën se si produkti trajtohet nga palët që janë të ndryshme nga prodhuesi, në mënyrë që të lehtësohet përdorimi i duhur, operacionet e ruajtjes së vlerës dhe trajtimi korrekt në fund të jetës;
2. Informacioni i kërkuar shfaqet në pasaportën digjitale të produktin me ndikim në energji, kur kjo pasaportë është e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse, në përputhje sipas neneve 24 dhe 25, dhe kur është e nevojshme, shfaqet në një ose më shumë formate të mëposhtme:
- (a) Në vetë produktin;
 - (b) Në paketimin e produktit;
 - (c) Në një etiketë në përputhje me Ligjin 52/2024 “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”;
 - (d) Në një manual përdorimi ose dokumentacion tjetër që shoqëron produktin;
 - (e) Në një faqe interneti ose aplikacion me akses falas.

Neni 11

Detyrimet e importuesit

1. Kur prodhuesi nuk është i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në mungesë të një përfaqësuesi të autorizuar, importuesi ka detyrimet e mëposhtme:
- (a) Të garantojë që produkti i vendosur në treg dhe/ose i vënë në shërbim është në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (b) Të mbajë dhe të vërë në dispozicion deklaratën CE të konformitetit dhe dokumentacionin teknik;
 - (c) Të sigurojë që produkti me ndikim në energji të shoqërohet me informacionin e kërkuar sipas nenit 10 dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (ç) Të sigurojë që një produkt me ndikim në energji, në përputhje me kërkesat e projektimit ekologjik, të ketë markën e kërkuar CE të përmendur në nenin 6, aty ku është e zbatueshme, në përputhje me rregullat dhe kushtet e përmendura, ose markën alternative të konformitetit siç parashikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, dhe të shoqërohet me dokumentet e kërkuara, dhe se prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 12 (5) dhe (6).
2. Kur importuesit vlerësojnë ose kanë arsye të besojnë se një produkt nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, ata nuk e vendosin në treg ose nuk e vënë në shërbim produktin me ndikim në energji derisa të plotësojë kërkesat.
3. Për produktet me ndikim në energji të mbuluara nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, importuesit publikojnë emrin e tyre, emrin tregtar të regjistruar ose markën e regjistruar tregtare, adresën postare dhe mjetet elektronike të komunikimit përmes të cilave ata mund të kontaktohen:
- (a) Në versionin publik të pasaportës digjitale të produktit, kur kjo pasaportë është e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse; dhe

- (b) Në produkt ose, kur kjo nuk është e mundur, në paketim, ose në një dokument që shoqëron produktin.
4. Importuesit sigurojnë që një produkt me ndikim në energji të mbuluar nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të shoqërohet me udhëzime digjitale në gjuhën shqipe.
 5. Importuesit sigurojnë që, teksa një produkt është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e ruajtjes ose transportit të mos rrezikojnë plotësimin nga ana e tij e kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
 6. Importuesit informojnë menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për mosrespektimin e dyshuar të kërkesave dhe për çdo veprim korrigjues të ndërmarrë.
 7. Importuesit mbajnë një kopje të deklaratës së konformitetit të CE-së në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut dhe sigurojnë që dokumentacioni teknik mund t'u vihet në dispozicion, sipas kërkesës, për një periudhë 10-vjeçare, pasi një produkt me ndikim në energji i mbuluar nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji është vendosur në treg ose është vënë në shërbim, përveç rasteve kur specifikohet një periudhë tjetër.

Neni 12

Detyrimet e prodhuesëve

1. Prodhuesit, kur vendosin në treg ose vënë në shërbim produkte me ndikim në energji, të mbuluara nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, sigurojnë që:
 - (a) Produktet janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (b) Produktet shoqërohen me informacionin e kërkuar sipas nenit 10 të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore;
2. Përpara vendosjes në treg ose vënies në shërbim të një produkti të mbuluar nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, prodhuesit janë të detyruar të kryejnë procedurën e vlerësimit të konformitetit dhe të hartojnë dokumentacionin teknik përkatës.

Kur konformiteti me kërkesat e projektimit ekologjik është demonstruar përmes kësaj procedure, prodhuesit hartojnë Deklaratën e Konformitetit të KE-së dhe vendosin markën CE, sipas nenit 6.
3. Prodhuesit janë të detyruar të ruajnë dokumentacionin teknik dhe Deklaratën e Konformitetit të BE-së për një periudhë prej 10 vitesh nga data e vendosjes në treg ose vënies në shërbim të produktit, përveç rasteve kur aktet nënligjore përcaktojnë ndryshe.
4. Prodhuesit sigurojnë që procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë prodhimit garantojnë përputhjen e produkteve të tyre me kërkesat ligjore.

Çdo ndryshim në procesin e prodhimit, projektimin ose karakteristikat e produktit, që mund të ndikojë në konformitetin e tij, duhet të merret në konsideratë dhe, nëse është e nevojshme, të kryhet një rivlerësim i konformitetit sipas paragrafit 2 të këtij neni.
5. Prodhuesit pajisin produktet me një numër lloji, serie ose element tjetër që mundëson identifikimin e tyre. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të madhësisë ose natyrës së produktit, informacioni duhet të jepet në paketim ose në një dokument shoqërues.
6. Për produktet me ndikim në energji të mbuluara nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, prodhuesit janë të detyruar të shfaqin emrin, markën tregtare të regjistruar, adresën

postare dhe mjetet elektronike të komunikimit, përmes të cilave mund të kontaktohen, si më poshtë:

- (a) Në bazën publike të pasaportës digjitale të produktit, kur kjo pasaportë është e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse;
 - (b) Në vetë produktin, ose, kur kjo nuk është e mundur, në paketimin e tij ose në një dokument shoqërues
7. Prodhuesit sigurojnë që produktet e tyre të shoqërohen me udhëzime digjitale të qarta, të lexueshme dhe të kuptueshme, sipas nenit 10, paragrafi 1 (ç), të këtij ligji.
- (a) Udhëzimet e sigurisë dhe shëndetit duhet të jenë të disponueshme edhe në format të printuar.
 - (b) Nëse konsumatori e kërkon, prodhuesi duhet të sigurojë një kopje të printuar të udhëzimeve digjitale, pa pagesë, brenda një muaji nga marrja e kërkesës.
8. Nëse prodhuesit konstatojnë ose kanë arsye të besojnë se një produkt i vendosur në treg ose i vënë në shërbim nuk përputhet me kërkesat ligjore, ata janë të detyruar të ndërmarrin menjëherë masa korrigjuese për të sjellë produktin në përputhje, ose ta tërheqin nga tregu. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të informohet menjëherë për mos përmbushjen e dyshuar të kërkesave dhe për veprimet korrigjuese të ndërmarra.
9. Prodhuesit duhet të vënë në dispozicion të publikut mjete komunikimi si numër telefoni, adresë elektronike ose seksion të dedikuar në faqen e tyre të internetit, duke marrë në konsideratë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Prodhuesit mbajnë një regjistër të ankesave dhe shqetësimeve për një periudhë jo më të gjatë se 5 vjet dhe e vënë atë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, kur kërkohet.
10. Prodhuesit janë të detyruar të ofrojnë, pas një kërkesë të arsyetuar struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar konformitetin e produkteve, duke përfshirë dokumentacionin teknik. Ky informacion duhet të sigurohet në format elektronik ose të printuar, brenda një afati jo më të gjatë se 15 ditë nga marrja e kërkesës nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut. Prodhuesit bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për çdo veprim korrigjues të nevojshëm për të siguruar përputhjen me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 13

Detyrimet e përfaqësuesve të autorizuar

1. Prodhuesi mund të emërojë një përfaqësues të autorizuar me anë të një autorizimi me shkrim. Detyrimet e parashikuara në nenin 12 (1) dhe hartimi i dokumentacionit teknik nuk janë pjesë e mandatit të përfaqësuesit të autorizuar.
2. Një përfaqësues i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në autorizimin e marrë nga prodhuesi. Autorizimi bën të mundur që përfaqësuesi i autorizuar të përmbushë sa vijon:
 - (a) Mban deklaratën e konformitetit të BE-së dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për 10 vjet, pasi një produkt me ndikim në energji, i mbuluar nga një akt nënligjor në zbatim të këtij ligji, është vendosur në treg ose është vënë në shërbim, përveç rasteve kur ka kaluar një periudhë tjetër e specifikuar në atë akt;

- (b) Bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, me kërkesën e tyre, për çdo masë të marrë në lidhje me rastet e mospërbushjen e kërkesave nga ana e produktit të mbuluar nga mandati i përfaqësuesit të autorizuar;
- (c) Pas një kërkesë të arsyetuar nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, i siguron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar konformitetin e një produkti, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda 15 ditëve të marrjes së një kërkesë të tillë; dhe
- (d) Ndërpret autorizimin, nëse prodhuesi vepron në kundërshtim me detyrimet e tij sipas këtij Ligji.

Neni 14

Detyrimet e shpërndarësve

1. Shpërndarësit, kur vendosin në treg një produkt me ndikim në energji që është i mbuluar nga një akt nënligjor në zbatim të këtij ligji, janë të detyruar të respektojnë kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
2. Para se të vendosin në treg një produkt me ndikim në energji të mbuluar nga një akt nënligjor në zbatim të këtij ligji, shpërndarësit duhet të verifikojnë që:
 - (a) Produkti të mbajë markën CE në përputhje me nenin 6 të këtij ligji, dhe, kur është e nevojshme, të jetë i etiketuar ose të ketë një pasaportë digjitale produkti në përputhje me aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji;
 - (b) Produkti të shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar dhe me udhëzime digjitale, të cilat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të lexueshme, dhe të përmbajnë informacionin e përcaktuar në nenin 10, siç specifikohet në aktin nënligjor në zbatim të këtij ligji;
 - (c) Prodhuesi dhe importuesi të kenë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 11 dhe dhe nenin 12 të këtij ligji.
3. Në rast se shpërndarësit vlerësojnë ose kanë arsye të bazohen që një produkt, para se të vihet në treg, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, ata nuk duhet ta vendosin atë produkt në treg derisa të plotësohen kërkesat ose derisa prodhuesi të respektojë rregullat e caktuara. Shpërndarësit janë të detyruar të sigurojnë që, gjatë kohës kur produkti është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e ruajtjes ose transportit të mos rrezikojnë respektimin e kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore.
4. Në rast se shpërndarësit vlerësojnë ose kanë arsye të besojnë se një produkt që ata kanë vendosur në treg nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore, ata duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta përshtatur atë produkt me kërkesat, për ta tërhequr atë nga tregu ose për ta hequr atë nga tregu, nëse kërkohet.

Shpërndarësit janë të detyruar të informojnë menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për çdo mosrespektim të dyshuar të kërkesave dhe për çdo veprim korrigjues të ndërmarrë.
5. Shpërndarësit, pas një kërkesë të arsyetuar nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, janë të detyruar të ofrojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në dispozicion të tyre që është i nevojshëm për të vërtetuar konformitetin e produktit. Ky informacion dhe

dokumentacion duhet të dorëzohet në formë të printuar ose elektronike, brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e kërkesës nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

6. Shpërndarësit janë të detyruar të bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut në lidhje me çdo veprim korrigjues që duhet të ndërmerret për të korrigjuar çdo mospërputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 15

Detyrimet e tregtarëve

1. Tregtarët janë të detyruar të sigurojnë që konsumatorët e tyre të kenë akses në çdo informacion përkatës që shoqëron produktet, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, duke përfshirë edhe rastin e shitjes në distancë.
2. Tregtarët janë të detyruar të sigurojnë që pasaporta digjitale e produktit të jetë lehtësisht e aksesueshme për konsumatorët, kur kjo pasaportë është e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse, duke përfshirë edhe rastin e shitjes në distancë, siç përcaktohet në pikën (d) të paragrafit 2 të nenit 24 dhe siç specifikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
3. Tregtarët, duke përfshirë edhe rastin e shitjes në distancë, janë të detyruar:
 - (a) Të shfaqin për konsumatorët e mundshëm, në mënyrë të dukshme, etiketat parashikuara sipas pikës (b) ose (c) të nenit 16(2);
 - (b) Të referohen informacionit të përfshirë në etiketat e parashikuara sipas pikës (b) ose (c) të nenit 16(2), në reklamat vizuale ose në materialin teknik reklamues për një model specifik, në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (c) Të mos japin ose shfaqin etiketa, shenja, simbole ose mbishkrime të tjera që mund të mashtrojnë ose ngatërrojnë konsumatorët në lidhje me informacionin e përfshirë në etiketë për kërkesat e projektimit ekologjik.

Neni 16

Detyrimet që lidhen me etiketat

Për produktet e lidhura me energjinë që i nënshtrohen etiketave të energjisë, të krijuara sipas Ligjit 52/2024 “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, ku informacioni për një parametër përkatës të produktit, duke përfshirë performancën e produktit të përmendur në nenin 10, paragrafi 1 (b) të këtij ligji, nuk mund të përfshihet në etiketën e energjisë, dhe me kusht që një informacion i tillë vlerësohet si më i rëndësishëm dhe më gjithëpërfshirës se sa informacioni i mbuluar nga etiketa e energjisë, pasi bëhet një vlerësim mbi rrezikun e konfuzionit për konsumatorët, barrën administrative për operatorët ekonomikë dhe mënyrën më të mirë për të komunikuar atë informacion të veçantë, nëse është e nevojshme, mund të kërkojë vendosjen e një etikete sipas këtij ligji, në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të tij në vend të etiketës së energjisë të vendosur sipas Ligjit 52/2024 .

Neni 17

Detyrimet e ofruesve të shërbimeve të magazinimit dhe paketimit

Ofruesit e shërbimeve të magazinimit dhe paketimit sigurojnë që, për produktet që ata trajtojnë, të cilat mbulohen nga një akt nënligjor në zbatim të këtij ligji, kushtet gjatë ruajtjes, paketimit, dërgimit ose dorëzimit të mos rrezikojnë respektimin nga ana e produkteve e atij akti.

Neni 18

Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesve zbatohen ndaj importuesve dhe shpërndarësve

Për qëllimet e këtij ligji, importuesit ose shpërndarësit konsiderohen si prodhues në rastet e mëposhtme:

- (a) Kur vendosin në treg një produkt të mbuluar nga një akt nënligjor në zbatim të këtij ligji, nën emrin ose markën e tyre tregtare; ose
- (b) Kur modifikojnë një produkt të tillë që është vendosur tashmë në treg, në një mënyrë që ndikon në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 19

Detyrimet e operatorëve ekonomikë për informacionin

1. Kur vendosin në treg një produkt të mbuluar nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji nëpërmjet shitjes në distancë, operatorët ekonomikë janë të detyruar të sigurojnë që oferta e produktit të paraqesë, në mënyrë të qartë dhe të dukshme, informacionin e mëposhtëm:
 - (a) Emrin, emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare të prodhuesit, si dhe adresën postare dhe elektronike ku mund të kontaktohet prodhuesi;
 - (b) Informacion që bën të mundur identifikimin e produktit, duke përfshirë një foto të tij, llojin e tij dhe çdo identifikues tjetër të produktit.
2. Me kërkesë të arsyetuar, operatorët ekonomikë janë të detyruar t'u japin strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut:
 - (a) Emrin e çdo operatori ekonomik që i ka furnizuar ata me një produkt që është objekt i një akti nënligjor në zbatim të këtij ligji;
 - (b) Emrin e çdo operatori ekonomik të cilin e kanë furnizuar me këto produkte, si dhe sasitë dhe modelet e sakta të këtyre produkteve.
3. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të sigurojnë që të jenë në gjendje të japin informacionin e përmendur në pikën e parë të këtij paragrafi për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh nga data kur janë furnizuar me produktet përkatëse dhe për 10 (dhjetë) vjet nga data kur kanë furnizuar produkte të tilla, përveç rasteve kur në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji është specifikuar një periudhë e ndryshme. Ky informacion duhet të dorëzohet në formë të printuar ose elektronike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

Neni 20

Detyrimet e monitorimit dhe raportimit të operatorëve ekonomikë

1. Kur prodhuesve, përfaqësuesve të tyre të autorizuar ose importuesve u kërkohet të vënë në dispozicion strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut informacion mbi sasitë e një produkti, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr parasysh kriteret e mëposhtme:
 - (a) Disponueshmërinë e provave lidhur me depërtimin në treg të produktit përkatës, që është i nevojshëm për të lehtësuar shqyrtimin e akteteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat zbatohen për atë produkt;
 - (b) Nevojën për të shmangur një barrë administrative të tepruar për operatorët ekonomikë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të); dhe
 - (c) Dobinë dhe proporcionalitetin e informacionit të kërkuar në raport me qëllimin e tij.Struktura përgjegjëse mbikëqyrjes së tregut përcakton periudhën që mbulon informacioni i përmendur në paragrafin e parë. Ky informacion diferencohet sipas modelit të produktit. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut përcakton mjetet përmes të cilave informacioni përkatës duhet t'i vihet në dispozicion, si dhe frekuencën e ofrimit të këtij informacioni. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut siguron që informacioni i vënë në dispozicion të përpunohet në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me legjislacionin përkatës.
2. Kur kërkohet që një produkt të jetë në gjendje të masë energjinë që konsumon gjatë përdorimit ose performancën e tij në lidhje me parametrat e tjerë përkatës të në përputhje me aktin nënligjor, të hartuar sipas nenit 23 të këtij ligji, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr parasysh kriteret e mëposhtme:
 - (a) Dobinë e të dhënave të përdorimit për përdoruesit fundorë, në mënyrë që ata të kuptojnë dhe menaxhojnë përdorimin e energjisë ose performancën e produktit;
 - (b) Fizibilitetin teknik të regjistrimit të të dhënave gjatë përdorimit;
 - (c) Nevojën për të shmangur një barrë administrative të tepruar për operatorët ekonomikë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të); dhe
 - (ç) Nevojën për të siguruar që të mos mblidhen të dhëna që mundësojnë identifikimin e individëve ose vëzhgimin e sjelljes së tyre.
3. Produktet me ndikim në energji duhet të regjistrojnë, sipas rastit, të dhënat gjatë përdorimit në përputhje me kriteret e paragrafit 2 të këtij neni dhe t'i bëjnë këto të dhëna të dukshme për përdoruesit përfundimtarë.
4. Kur prodhuesve, përfaqësuesve të tyre të autorizuar ose importuesve u kërkohet të mbledhin të dhëna jopersonale gjatë përdorimit, të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, dhe t'ia raportojnë këto të dhëna strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr në konsideratë kriteret e mëposhtme:
 - (a) Dobinë e të dhënave jopersonale gjatë përdorimit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut,
 - (b) Nevojën për të shmangur një barrë administrative të tepruar për operatorët ekonomikë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të).
5. Kërkesat e përmendura në paragrafin 4 mund të përfshijnë veçanërisht:
 - (a) Mbledhjen e të dhënave jopersonale gjatë përdorimit, nëse ato mund të aksesohen nga distanca përmes internetit, pas pëlqimit të qartë të dhënë nga përdoruesi përfundimtar për t'i vënë në dispozicion ato të dhëna; dhe

- (b) Raportimin e atyre të dhënave pranë strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, të paktën një herë në vit.
- 6. Ministria përgjegjëse për ekonominë specifikon, në aktin përkatës nënligjor në zbatim të këtij ligji, detajet dhe formatin për raportimin e të dhënave jopersonale gjatë përdorimit, siç përmendet në paragrafin 4.

Neni 21

Kërkesat për komponentët dhe nën-komponentët

Kërkesat e projektimit ekologjik mund të parashikojnë që prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i cili vendos në treg ose vë në shërbim komponentë dhe nën-komponentë, të jetë i detyruar t'i ofrojë prodhuesit të një produkti me ndikim në energji, të mbuluar nga aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji, informacionin përkatës në lidhje me:

- (a) Përbërjen e materialeve;
- (b) Konsumin e energjisë;
- (c) Materialet dhe/ose burimet e komponentëve ose nën-komponentëve.

Neni 22

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

- 1. Në kuadër të programeve mbështetëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe ndërmarrjet shumë të vogla, autoritetet kompetente marrin në konsideratë iniciativat që ndihmojnë këto ndërmarrje në integrimin e aspekteve mjedisore, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, në procesin e projektimit të produkteve të tyre.
- 2. Nëse është e nevojshme dhe në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet kompetente mund të përgatisin materiale specifike për të lehtësuar zbatimin e këtij ligji nga NVM-të.

Neni 23

Kërkesat e projektimit ekologjik

- 1. Kërkesat e projektimit ekologjik, informacioni i dhënë nga prodhuesi dhe procedurat për verifikimin e përputhshmërisë për çdo produkt me ndikim në energji, i cili plotëson kriteret e renditura në pike 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë. Vendim përcakton në mënyrë të vecantë:
 - (a) Përcaktimin e grupit ose grupeve të produkteve të mbuluara, duke përfshirë listën e kodeve të mallrave siç përcaktohet në Ligjin Nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe përshkrimet e produktit;
 - (b) Kërkesat e informacionit të përcaktuara në nenin 10.
 - (c) Kërkesat e projektimit ekologjik për grupet e produkteve të mbuluara në përputhje me pikën 5 të këtij neni;
 - (ç) Parametrat e produktit për të cilat nuk nevojiten kërkesa të projektimit ekologjik;
 - (d) Standardet ose metodat e testimit, matjes ose llogaritjes që do të përdoren sipas nenit 29(1);

- (dh) Kërkesat për përdorimin e mjeteve digjitale, kur është e nevojshme, sipas nenit 29(2);
 - (e) Sipas rastit, standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian, ose specifikimet e përbashkëta që do të përdoren;
2. Kriteret e përmendura në pikën 1 janë si më poshtë:
- (a) Produkti duhet të përfaqësojë një vëllim të konsiderueshëm të shitjeve dhe tregtisë, përkatësisht më shumë se 200,000 njësi në vit brenda Republikës së Shqipërisë sipas shifrave më të fundit në dispozicion;
 - (b) Produkti, duke marrë parasysh sasinë e vendosura në treg dhe/ose të vëna në shërbim, duhet të ketë një ndikim të konsiderueshëm mjedisor brenda Republikës së Shqipërisë; dhe
 - (c) Produkti duhet të paraqesë potencial të konsiderueshëm për përmirësim në aspektin e ndikimit të tij mjedisor pa shkaktuar kosto të tepërta.
3. Kërkesat e projektimit ekologjik duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:
- (a) Nuk duhet të kenë asnjë ndikim negativ të konsiderueshëm mbi funksionalitetin e produktit, nga këndvështrimi i përdoruesit;
 - (b) Nuk duhet të ndikojnë negativisht në aspektet e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit;
 - (c) Nuk duhet të kenë ndikim negativ të konsiderueshëm tek konsumatorët, veçanërisht për sa i përket përballueshmërisë ekonomike dhe koston e ciklit jetësor të produktit;
 - (ç) Nuk duhet të kenë ndikim negativ të konsiderueshëm mbi konkurrueshmërinë e sektorit të industrisë;
 - (d) Në parim, përcaktimi i një kërkesë për projektimin ekologjik për produktet me ndikim në energji nuk duhet të imponojë teknologji komerciale tek prodhuesit; dhe
 - (dh) Prodhuesit nuk duhet të ngarkohen me asnjë lloj barrë të tepruar administrative.
4. Kërkesat duhet të formulohen në atë mënyrë që garantojnë verifikimin nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut të konformitetit të produktit me kërkesat e projektimit ekologjik. Kërkesat e projektimit ekologjik duhet të specifikojnë nëse verifikimi mund të kryhet drejtpërdrejt mbi produktin ose në bazë të dokumentacionit teknik.
5. Kërkesat e projektimit ekologjik duhet të përfshijnë elementët:
- (a) Përkufizimin e saktë të llojit/eve të produktit/eve të mbuluar/a;
 - (b) Kërkesën/kërkesat e projektimit ekologjik për produktin/produktet e mbuluara, datën/datat e zbatimit, rregulloret ose periudhat graduale apo kalimtare;
 - (c) Kërkesat në lidhje me pasaportën digjitale në përputhje me nenin 24 të këtij ligji, kur kjo pasaportë është e përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse;
 - (ç) Parametrat e projektimit ekologjik;
 - (d) Kërkesat për instalimin e produktit kur ai ka lidhje të drejtpërdrejtë me performancën mjedisore të produktit të marrë në konsideratë;
 - (dh) Standardet e matjes dhe/ose metodat e matjes që do të përdoren; aty ku ekzistojnë, duhet të përdoren standardet e harmonizuara;
 - (e) Detajet për vlerësimin e konformitetit sipas Ligjit nr. 10489/2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij;

- (ë) Kërkesat për informacionin që duhet të ofrohet nga prodhuesit, veçanërisht në lidhje me elementet e dokumentacionit teknik që nevojiten për të bërë të mundur verifikimin e konformitetit të produktit me kërkesat e përkatëse të projektimit ekologjik;
 - (f) Kohëzgjatjen e periudhës kalimtare të përkohshme gjatë së cilës duhet të lejohet vendosjes në treg dhe/ose vënien në shërbim të produkteve që janë në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (g) Datën e vlerësimit dhe rishikimit të mundshëm të kërkesës së projektimit ekologjik, duke marrë parasysh shpejtësinë e progresit teknologjik.
6. Kërkesat e projektimit ekologjik përcaktohen për një grup produkti specifik. Ato mund të diferencohen për çdo produkt specifik që i përket atij grupi produkti specifik.
7. Produktet, qëllimi i vetëm i të cilave është t'i shërbejnë mbrojtjes ose sigurisë kombëtare, përjashtohen nga grupet e produkteve.
8. Kur dy ose më shumë grupe produktesh shfaqin një ose më shumë ngjashmëri duke bërë të mundur që një aspekt produkti të përmirësohet në mënyrë efektive bazuar në kërkesat e zakonshme të informacionit ose kërkesat e performancës, për ato grupe produktesh mund të vendosen kërkesat horizontale të projektimit ekologjik ("kërkesat horizontale të projektimit ekologjik").

Neni 24

Pasaporta digjitale e produktit

1. Në zbatim të paragrafit 2 të nenit 10, produktet me ndikim në energji mund të vendosen në treg ose mund të vihen në shërbim vetëm nëse disponohet një pasaportë digjitale e produktit me ndikim në energji, kur kjo kërkesë është përcaktuar në aktet në zbatim të këtij ligji dhe kur specifikimet teknike përkatëse janë të disponueshme.
2. Kërkesat në lidhje me pasaportën digjitale të renditura në paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohen në përputhje me aktet nënligjore të hartuara sipas nenit 23 të këtij ligji.
3. Kërkesat në lidhje me pasaportën digjitale të produktit specifikojnë, sipas rastit, për grupet e produkteve të mbuluara, sa vijon:
- (a) Të dhënat që duhet të përfshihen në pasaportën digjitale të produktit;
 - (b) Një ose më shumë bartës të të dhënave që do të përdoren;
 - (c) Paraqitjen, në të cilën do të tregohet bartësi i të dhënave dhe pozicionimi i tij;
 - (ç) Nëse pasaporta digjitale e produktit do të vendoset në nivel modeli, grupi ose artikulli, dhe përkufizimi i këtyre niveleve;
 - (d) Mënyrën në të cilën pasaporta digjitale e produktit duhet të bëhet e aksesueshme për konsumatorët përpara se ata të jenë subjekt i detyrimeve që lindin nga një kontratë për shitje, qira ose qira-blerje, duke përfshirë në rastin e shitjes në distancë sa më poshtë vijon;
 - (dh) Operatorët ekonomikë që duhet të kenë akses në të dhënat që ndodhen në pasaportën digjitale të produktit;
 - (e) Operatorët ekonomikë që duhet të krijojnë një pasaportë digjitale të produktit ose të përditësojnë të dhënat në pasaportën digjitale të produktit dhe cilat të dhëna mund të prezantojnë ose përditësojnë;

- (ë) Organizimet e detajuara për regjistrimin ose përditësimin e të dhënave;
 - (f) Periudha gjatë së cilës pasaporta digjitale e produktit është e disponueshme, e cila duhet të korrespondojë, të paktën, me jetëgjatësinë e pritshme të një produkti të caktuar me ndikim në energji.
4. Kërkesat e përmendura në paragrafin 3:
- (a) Sigurojnë që operatorët ekonomikë përgjatë zinxhirit të vlerës mund të kenë akses dhe të kuptojnë lehtësisht informacionin e produktit që lidhet me ta;
 - (b) Lehtësojnë verifikimin e konformitetit të produktit nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut; dhe
 - (c) Përmirësojnë gjurmueshmërinë e produkteve përgjatë zinxhirit të vlerës.
5. Gjatë përcaktimit të kërkesave në lidhje me pasaportën digjitale të produktit, ministria përgjegjëse për ekonominë mund të përjashtojë grupet e produkteve nga kërkesa për të pasur një pasaportë digjitale produkti kur specifikimet teknike të pasaportës digjitale të produktit nuk janë të disponueshme në lidhje me kërkesat thelbësore të përfshira në nenet 10 dhe 11.

Neni 25

Kërkesat e pasaportës digjitale të produktit

1. Pasaporta digjitale e produktit është në përputhje me kërkesat thelbësore të mëposhtme:
 - (a) Ajo duhet të lidhet nëpërmjet një bartësi të dhënash me një identifikues unik të vazhdueshëm të produktit;
 - (b) Bartësi i të dhënave është fizikisht i pranishëm në produkt, në paketimin e tij ose në dokumentacionin që shoqëron produktin, siç specifikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (c) Të dhënat personale në lidhje me konsumatorët nuk ruhen në pasaportën digjitale të produktit pa miratimin e tyre;
 - (ç) Të dhënat e përfshira në pasaportën digjitale të produktit i referohen modelit, grupit ose artikullit të produktit siç specifikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (d) Aksesit në të dhënat e përfshira në pasaportën digjitale të produktit rregullohet në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në këtë nen dhe me të drejtat specifike të aksesit në nivel grupi produktesh siç specifikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.
2. Operatori ekonomik që vendos produktin në treg:
 - (a) U ofron tregtarëve dhe ofruesve të tregjeve në internet një kopje digjitale të bartësit të të dhënave ose të identifikuesit unik të produktit, sipas rastit, për t'u mundësuar atyre që ta bëjnë bartësin e të dhënave ose identifikuesin unik të produktit të aksesueshëm për konsumatorët e mundshëm kur ata nuk mund të kenë akses fizikisht tek produkti;
 - (b) Siguron kopjen digjitale të përmendur në pikën (a) ose një lidhje të faqes në internet pa pagesë menjëherë dhe në çdo rast brenda pesë ditëve pune nga marrja e një kërkesë për ta bërë këtë.
3. Kur është e disponueshme, gjatë vendosjes së produktit në treg, operatori ekonomik vë në dispozicion një kopje rezervë të pasaportës digjitale të produktit përmes ofruesit të shërbimit të pasaportës digjitale të produktit.

Neni 26

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

1. Detyrimi për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryhet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.
2. Struktura përgjegjëse ka të drejta si më poshtë:
 - (a) organizon kontrollet e duhura në lidhje me konformitetin e produktit, në masën e nevojshme, dhe të detyrojë prodhuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar që të tërheqë nga tregu produktet që nuk i plotësojnë kërkesat e parashikuara, në përputhje me nenin 23;
 - (b) kërkon nga palët e interesuara të gjithë informacionit të nevojshëm, siç specifikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - (c) merr mostra të produkteve dhe kryen teste të konformitetit për saktësinë e informacionit në laboratorë të akredituar për këtë qëllim. Në rastet kur në bazë të një raporti testimi zbulohen Produktet nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji, të gjitha shpenzimet për kryerjen e raportit të testimit mbulohen nga prodhuesi. Në të kundërt, shpenzimet mbulohen nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut;
 - (ç) vendos rregullore administrative në përputhje me këtë ligj;
3. Të gjitha veprimtaritë e nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv të këtij ligji do të përfshihen në programin vjetor të inspektimit për vitin pasardhës.
4. Programi vjetor i inspektimit hartohet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë (ekominë). Një kopje e programit i dërgohet ministrisë përgjegjëse për energjinë.
5. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut raporton brenda datës 31 mars pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë dhe ministrisë përgjegjëse për energjinë për numrin e inspektimeve të kryera për vitin kalendarik paraardhës. Kjo e fundit raporton te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë sipas detyrimeve dhe parashikimeve në fuqi.
6. Format i raportimit, sipas pikës 5, hartohet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për tregtinë.
7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për tregtinë dhe të ministrit përgjegjës për energjinë, miraton afatet dhe procedurën e detajuar që ndiqet nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut për zbatimin e kompetencave të saj.

Neni 27

Kompetencat e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut ka këto kompetenca dhe funksione:
 - (a) Verifikojë përputhshmërinë e produkteve të vendosura në treg ose të vëna në shërbim me kërkesat e projektimit ekologjik, në përputhje me nenin 7 dhe nenin 9 të këtij ligji;
 - (b) Kërkojë dhe sigurojë dokumentacionin teknik, deklaratat e konformitetit dhe, kur është e disponueshme, informacionin mbi pasaportën digjitale të produktit, brenda afateve të përcaktuara në nenin 7 (6), nenin 12 (8) dhe nenin 13 pika (a) dhe (c);

- (c) Verifikojë të dhënat e përfshira në pasaportën digjitale të produktit dhe pajisjen e produktit me bartësin e të dhënave, në përputhje me nenet 24 dhe 25;
 - (ç) Përcakton formatin, mjetet dhe frekuencën e raportimit të të dhënave nga operatorët ekonomikë, si dhe periudhën që duhet të mbulojë informacioni, duke marrë parasysh proporcionalitetin, rëndësinë dhe shmangien e barrës administrative të tepruar për operatorët ekonomikë, veçanërisht për NVM-të;
 - (d) Siguron që të dhënat e raportuara të përpunohen në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe transparencën;
 - (dh) Kërkon, në rastet kur është e parashikuar në ligj, që produktet të jenë të afta të masin të dhëna gjatë përdorimit, siç janë konsumi i energjisë ose parametra të performancës, dhe që këto të dhëna t'u shfaqen përdoruesve fundorë në mënyrë të kuptueshme;
 - (e) Bashkëpunojë me prodhuesit, importuesit, përfaqësuesit e autorizuar, shpërndarësit dhe tregtarët për marrjen e masave korrigjuese, në përputhje me nenet 11, 12, 13, 14 dhe 15;
 - (ë) Të informohet menjëherë nga operatorët ekonomikë për çdo rast të dyshuar të mospërputhshmërisë dhe të marrë masat përkatëse.
2. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut mund të bashkëpunojë me autoritetet doganore, trupat inspektuese dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin efektiv të këtij ligji dhe parandalimin e vendosjes në treg të produkteve jo-konforme.
 3. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut ushtron kompetencat e saj në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik.

Neni 28

Procedura për trajtimin e produkteve që paraqesin risk në nivel kombëtar

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut disponon arsye të mjaftueshme për të vërtetuar se një produkt i mbuluar nga ky ligj paraqet rrezik për aspektet e mbrojtjes së interesit publik, siç janë aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, do të kryejë një vlerësim për produktin në fjalë, që mbulon të gjitha kërkesat e projektimit ekologjik, që lidhen me rrezikun, dhe ato të përcaktuara në këtë ligj ose në aktin përkatës nënligjor. Operatorët ekonomikë do të bashkëpunojnë sipas nevojës me struktura përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për realizimin e vlerësimit.
2. Kur gjatë vlerësimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se produkti nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj ose në aktin përkatës nënligjor, ai do t'i kërkojë pa vonesë operatorit ekonomik të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura korrigjuese:
 - (a) për të përafuar produktin në përputhje me këto kërkesa;
 - (b) për të tërhequr produktin nga tregu; ose,
 - (c) për ta tërhequr atë brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut, brenda afatit të vlerësuar prej tyre.

Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konsideron se një rast mospërputhjeje, siç përmendet në pikën 2 të këtij neni, nuk është i kufizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, ai njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe palët e kontraktuara për rezultatet e

vlerësimit, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, dhe për veprimet që ata kanë kërkuar operatorët ekonomikë duhet të marrin.

3. Operatorët ekonomikë ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura korrigjuese ose kufizuese në përputhje me pikën 2 të këtij neni për të gjitha produktet e konstatuara, që ka bërë të disponueshme në treg.
4. Kur operatorët ekonomikë nuk ndërmarrin veprime të duhura korrigjuese brenda periudhës së përmendur në pikën 2 të këtij neni, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar ose kufizuar disponueshmërinë e produktit në treg ose për të tërhequr produktin nga tregu.
5. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut informon Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe palët e tjera kontraktuese për masat e marra, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, brenda 2 ditëve pune, prej momentit të marrjes së masave. Informacioni i dërguar përfshin të gjitha detajet e disponueshme, si dhe:
 - (a) të dhënat e nevojshme për identifikimin e produktit që nuk përputhet;
 - (b) origjinën e produktit;
 - (c) natyrën e mospërputhshmërisë së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë;
 - (d) natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të marra dhe argumentet e paraqitura operatorët ekonomikë.

Në veçanti, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut qartëson nëse mospërputhja është për shkak se produkti nuk arrin të përmbushë kërkesat në lidhje me aspektet e mbrojtjes së interesit publik, të përcaktuara në këtë ligj, apo për shkak të mangësive në standardet e harmonizuara, që japin një supozim mbi konformitetin.

6. Kur brenda 60 ditëve kalendarike nga marrja e informacionit, të përmendur në pikën 5 të këtij neni, nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga një palë kontraktuese ose nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me një masë provizore të marrë nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, ajo masë do të konsiderohet të jetë e justifikuar.
7. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut siguron që masat e ndërmarra kufizuese, të tilla si tërheqja e produktit nga tregu janë realizuar brenda një periudhe sa më të shkurtër.
8. Kur standardet e harmonizuara të Bashkimit Evropian zbatohen gjatë vlerësimit të konformitetit të një produkti, modeli do të supozohet se është në përputhje me kërkesat përkatëse të matjes dhe llogaritjes së aktit nënligjor.
9. Autoritetet doganore, kur konstatojnë produkte që nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, njoftojnë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i cili mund të urdhërojë marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj për garantimin e sigurisë së përdoruesve fundorë.
10. Për çdo procedurë të nisur nga një palë kontraktuese, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut njofton Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe palët e tjera kontraktuese për çdo masë të ndërmarrë për produktin për të cilin nis procedura lidhur me mospërputhshmërinë dhe në rast mosmarrëveshjeje, me masën kombëtare të kundërshtimeve të njoftuara prej të tyre.

Neni 29

Metodat e testimit, matjes dhe llogaritjes

1. Për qëllime të konformitetit dhe verifikimit të saj me kërkesat e projektimit ekologjik, testet, matjet dhe llogaritjet duhet të realizohen duke përdorur standarde të harmonizuara ose metoda

të tjera të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme, të cilat janë në përputhje me metodat e njohura të teknologjisë moderne. Këto metoda duhet të plotësojnë kërkesat për metodat e testimit, matjes dhe llogaritjes të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

2. Kur shqyrton kërkesën për përdorimin e mjeteve digjitale për të llogaritur performancën e një produkti në lidhje me një parametër produkti, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr parasysh kriteret e mëposhtme:

- (a) Nevojën për të siguruar zbatimin e harmonizuar të metodave të llogaritjes; dhe
- (b) Nevojën për të minimizuar barrën administrative që u ngarkohet operatorëve ekonomikë.

Mjetet digjitale duhet të jenë lirisht të aksesueshme për operatorët ekonomikë.

Neni 30

Parandalimi i anashkalimit dhe përkeqësimit të performancës

1. Operatorët ekonomikë nuk angazhohen në asnjë veprim që dëmton përputhshmërinë e produkteve me këtë ligj, pavarësisht nëse ky veprim ka natyrë kontraktuale, tregtare, teknike apo ndonjë formë tjetër.
2. Produktet me ndikim në energji që përfshihen në objektin e një akti nënligjor në zbatim të këtij ligji nuk mund të vendosen në treg ose të vihen në shërbim nëse janë krijuar për të ndryshuar sjelljen ose vetitë e tyre gjatë testimit, me qëllim që të arrihet një rezultat më i favorshëm për cilindo nga parametrat e produktit të rregulluar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Për qëllimet e këtij paragrafi, produktet e krijuara për të ndryshuar sjelljen ose vetitë e tyre gjatë testimit, si dhe për të ndryshuar automatikisht performancën e tyre si reagim, si dhe produktet e paracaktuara për të ndryshuar performancën e tyre gjatë testimit, konsiderohen si produkte të krijuara për të ndryshuar sjelljen ose vetitë e tyre kur janë nën testim.
3. Operatorët ekonomikë që vendosin në treg ose vënë në shërbim një produkt të mbuluar nga një akt nënligjor në zbatim të këtij ligji nuk duhet të përshkruajnë udhëzime specifike për testimin që ndryshojnë sjelljen ose vetitë e produktit për të arritur një rezultat më të favorshëm për cilindo nga parametrat e produktit të rregulluar nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Për qëllimet e këtij paragrafi, udhëzimet që çojnë në një ndryshim manual të produktit, para se të kryhet një test që ndikon në performancën e produktit, konsiderohen si udhëzime specifike për testimin, të cilat ndryshojnë sjelljen ose vetitë e produktit.
4. Produktet që përfshihen në objektin e një akti nënligjor në zbatim të këtij ligji nuk vendosen në treg ose nuk vihen në shërbim, nëse janë krijuar për të ndryshuar sjelljen ose vetitë e tyre brenda një periudhe të shkurtër pas vënies në shërbim, duke çuar në një përkeqësim të performancës së tyre në lidhje me cilindo nga parametrat e produktit të rregulluar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, ose performancën e tyre funksionale nga këndvështrimi i përdoruesit.
5. Përditësimet e softuerit ose firmuerit nuk duhet të shkaktojnë përkeqësim të performancës së produktit përtej kufijve të pranueshëm të specifikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, lidhur me ndonjë nga parametrat e produktit të rregulluar në ato akte ose performancën funksionale nga këndvështrimi i përdoruesit, kur matet me metodën e testimit të përdorur për vlerësimin e konformitetit. Ky rregull nuk vlen nëse konsumatori ka pranuar shprehimisht përkeqësimin e mundshëm të performancës para përditësimit. Në rast se përditësimi refuzohet, nuk ka asnjë ndryshim të bërë

në

produkt.

Përditësimet e softuerit ose firmuerit nuk do të çojnë, në asnjë rast, në përkeqësimin e performancës së produktit, përveç nëse produkti nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat janë të zbatueshme në momentin e vendosjes në treg ose të vënies në shërbim të produktit.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut si më poshtë:
 - (a) për shkelje të nenit 4, pikës 1 të nenit 6, pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 7 dhe nenit 8 këtij ligji me gjobë në masën 300 000 lekë;
 - (b) për shkelje të parashikimeve të pikës 1 dhe 2 të nenit 9 të këtij ligji me gjobë në masën 300 000 lekë;
 - (c) për shkelje të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji me gjobë në masën 300 000 lekë;
 - (ç) për shkelje të parashikimeve të pikës 1 të nenit 11, nenit 12, pikës 2 të nenit 13, pikës 1, 2, 3 dhe 2 të nenit 14, nenit 15 dhe nenit 17 me gjobë në masën 350 000 lekë;
 - (d) për shkelje të parashikimeve të nenit 16 me gjobë në masën 300 000 lekë;
 - (dh) për shkelje të parashikimeve të neneve 19 dhe 20 me gjobë në masën 350 000 lekë;
 - (e) për shkelje të parashikimeve të pikës 1 të nenit 25 me gjobë në masën 350 000 lekë;
 - (ë) për bizneset e vogla, të klasifikuara si rezultat i xhiros vjetore, vlera e gjobës për secilën prej shkeljeve të mësipërme është 150 000 lekë.
2. Kur edhe pas marrjes së masave, sipas parashikimeve të këtij neni, operatori ekonomik rezulton se përsërit shkeljen për të njëjtin produkt, atëherë masat e gjobës dyfishohen.

Neni 32

Ankimi

1. Ankimi administrativ kundër vendimit për shkeljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Kur pas përfundimit të procedurës së përcaktuar në nenin 28, pikat 3 dhe 4, ngrihen kundërshtime kundër një mase të marrë nga një palë kontraktuese, ose kur Sekretariati konsideron se një masë kombëtare është në kundërshtim me vendimet e marra nga Komuniteti i Energjisë, Sekretariati do të konsultohet pa vonesë me palën kontraktuese dhe operatorin ekonomik dhe do të vlerësojë masën kombëtare.
3. Mbi bazën e rezultateve të atij vlerësimi, Sekretariati rekomandon nëse masa kombëtare është e justifikuar apo jo dhe mund të sugjerojë një masë alternative të përshtatshme.
4. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut mirëpret vlerësimet dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për produkte të caktuara dhe ndërmerr veprimet e nevojshme për të tërhequr nga tregu ose lejuar në treg produkte që nuk plotësojnë kriteret sipas këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore.
5. Masat korrigjuese ose kufizuese, në përputhje me pikat 2, 3, 4 ose 8 të nenit 28, ose me pikën 4 të nenit 32, do të shtrihen për të gjitha njësitë e një produkti me ndikim në energji, që nuk

përputhet dhe të modeleve të tij ekuivalente, përveç atyre njësive për të cilat operatori ekonomik demonstroi se ato janë në përputhje.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DRAFT